

AISHE ALIÇKAJ
MË LËR TË T'I PUTH ATA SY
POEZI TË ZGJEDHURA

BOTIMET TOENA

AISHE ALIÇKAJ

MË LËR TË T'I PUTH
ATA SY

Poezi të zgjedhura

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Shuaip Duka

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-817-38-9

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420.

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

MË LËR TË T'I PUTH ATA SY

Ti, shpirt i ngrohtë,
E bukura ime Shqipëri,
Legjendarja, shekullorja,
Më lër të t'i puth ata sy.

Të të puth lotin e ngrohtë
Të hidhur farmak,
Në sytë e shqipes,
Të flamurit gjak.

Të t'i puth ata lot,
Që paqshëm shkëlqejnë me jetë,
Kur rrëshqasin poshtë si meteorë
Dhe ndriçojnë fytyrën e zbehtë.
Fytyrën fisnike shformuar nga dhimbja,
Kur tërmeti ca gjymtyrë t'i mori në muzg
Dhe nga barku i dheut dëgjoheshin britma
Dhe këngë kukuvajkash nëpër rrugë.

GËZUAR, GËZUAR PËR SHUMË VJET

Gëzuar, gëzuar për shumë vjet!
Në çdo derë do të trokasë Viti i Ri.
Prapë do të trokasë mbi dhimbjen njerëzore,
Mbi mjerimin e kreshpëruar të shekullit të ri,
Ku trapezat e mbushura, ëndrrat përrallore,
Prapë do të mbeten të shkruara
Nëpër reklama, në memorie.

Të lutem, babagysh, të lutem sivjet,
Mes mjegullës-errësirë të vitit 2020,
Pak dritë, paqe, mëshirë të kristaltë,
Na sill, të lutem, prag më prag.
Një dritë jeshile, mes muzgut të bronzitë,
Një dritë jeshile mbi këtë planet,
Ku vdekja pushton çdo ditë
Shtratin, trapezën, qytetin, fshatin, vendin, qiellin e vet.

Pak paqe, shumë dashuri, mirësi, pëllumba,
Të trokasin në shpirtin, mendjen, portat,
Ku jeton revanshi i krimit,
Të trokas pa pushim, tek ata që çdo ditë,
Me gjak e me eshtra po mbysin njerëzimin.

JAM GRUA

Jam grua.
Kjo magji,
E vetmja mrekulli e gjithësisë
Që mbaj mbi supe.
Këtë bekim të natyrës e perëndisë
Dua ta përcjell tutje,
Në tokë, në ajër, në dete, në oqeanë, në male,
Ta shkund nga themelet botën,
me një mijë e një halle.

Jam grua.
Dielli, hëna, yjet, fëmija, dashuria, mirësia,
Çdo ditë në krevatin tim i hapin sytë.
Aty marrin jetë,
Bashkë me të mitë.

Jam grua.
E gjithësinë dua ta magjeps,
Pa lajka, pa bojëra,
Pa maska e mallkime,
Pa qenë nevoja të jem princeshë,
Apo zhveshur në rrugë në pjesët intime,
Por me freskinë e shpirtit,
Me vesë dashurie ta spërkas këtë botë,
Pa gjak, dhimbje dhe lot.
Që jeta të lulëzojë,
Dua të luftoj dhe me djajtë,
T'i këndoj heshtjes së zezë nëpër natë,
Të shurdhoj sirenat, hienat, dreqër e lugatë.

NËNA SHQIPËRI

Të uroj nga shpirti
Nëna Shqipëri,
Bekimet e botës
Të mbulofshin ty.
Të të fshihen nga memoria
Ç'kalove më parë.
Mbi trojet e tua
Mbretërofshin lulet!
Paç vetëm behar!

DHE KUR QAVA, DHE KUR QESHA

Dhe kur qava, dhe kur qesha,
Gjithmonë vetvetja mbeta.
S'i humba kurrë ato gjurmë
Aty ku do të shkelte shpresa.

Si humba kurrë ato gjurmë,
Me pishtar në dorë mbeta,
E shëndoshë a e sëmurë,
Mbi gjurmët e nënës fjeta.

DHEMB DASHURIA

Heshtje...
Heshtje prej stralli.
Një heshtje e dhimbshme,
Një heshtje prej varri.
Dashuria që dhemb,
Pranverën ka pushtuar,
Bari delikat vesën sikur tremb...
Aromë e gjelbëruar, nektari mbi lule,
Mbetën pa shijuar.
Dhe dhemb dashuria
Mbi gjokset e zjarra.
Prushin kush ta shuajë?
Nuk ka vesë përjashta,
Lulet s'u këputën, vyshkur mbetën shkret.
Djali i dashuruar, pret vetëm pret.
Pritje e lënduar, i madh siklet.
Zana, borëbardha mbyllur në gjerdek.
Dhemb kjo dashuria
Mbi buzën e nënës,
E tharë, e zhuritur,

Pa dritën e hënës, gjithnjë e fikur,
Për djalin, për vajzën, të dashurit e zemrës.

Pranvera lozonjare
Nuk ka sivjet naze,
Mungojnë shtojzovallet, dehur në oaze.
Dhemb heshtja sivjet, pranvera venitur,
Dhe gjyshet dhe gjyshërit mbetën duke pritur.

Mbyllur, të vetmuar,
Me sytë nga dera
Dhe malli përmbi thinja
Pret mos vjen pranvera.

Mbyllur të ngujuar,
Se në luftë jemi.
Me tinguj të panjohur
Pranvera erdhi.
Me tinguj të heshtur,
Pa nerva, pa gjak,
Me këngën e qyqes
Mbjellë në çdo prag.
Dhe njeriu pret dhe pret,
ja dhe pak,
Se drita e fikur
Mbase ndizet prapë.

NË VATHIN TIM NUK BIEN PRETË

Dhe në dritën e çirakut
Të pishës e të biçakut,
Dhe kur drita m'u ndërrua
Me elektrik e pirua,
Kurrë nuk u lodha shumë,
Të shkoja paratë në shtrungë.
E bëj lehtë këtë punë,
Ato s'më duan shumë,
Janë në mëri me mua,
Si ato dhitë xanxare,
Të zotin s'e duan fare.
Më largohen porsì erë
Në ca vathë të tjerë.

MË KA MARRË MALLI

Më ka marrë malli
Një mall prej mëndafshi,
I ëmbël si mjalti,
Më pushtoi të tërën.
Ulur këmbëkryq
Në odën e zemrës,
Unë dhe malli vetëm
Në dritën e hënës,
Në vetminë e femrës.

Honeve të shpirtit
Malli rrokulliset,
Dhe në krahë pëllumbash
Nis edhe hedh valle,
Bota e bardhë e femrës
Me yje qëndiset,
Dhe në ëndërrime
Tretet humbet fare.

Malli prej mëndafshi
Poshtë të rrëshqasë,
Të më mbështesë gushën,
Gushën të ma freskojë,
Me lotin e ëndrrës
Ta puth, ta fërkoj.
Poshtë të rrëshqas
Malli prej mëndafshi.
Me pjalmin e luleve
Mbi linjat e brishta
Ëmbël të më flasë.
Dhe gjuha e mallit
Të mos ndalë revanshin.
Të këpusë kopsat, fustanin ta grisë
Dhe mëndafshi i mallit të puthë buzë e gjinj.

S'MË IKËN KURRË AI MALL

Porta e shtëpisë mbi gurë,
Ngritur me mund e plot nur,
Më nxjerr mallin e fëminisë,
Ku u linda, piva sisë.

S'më ikën kurrë ai mall,
Me vete kudo e mbaj,
Luleshqerra në lëndinë
Manushaqe trëndelinë.

Dera e shtëpisë së madhe
Ngritur me mund e me halle,
Hapur ndenji ajo portë
Herë me gaz e herë me lot,
Herë me vaj, herë me valle,
Dëshmitarë janë ato male.

Ndaj kam mall e s'duroj dot
Ta shoh mbyllur atë portë,
Porta më e mirë në botë.
Duket sikur më pret nëna
Ulur mbi shilte të rënda.

QË DITËN QË TUNDA DJEPIN

Atë ditë që tunda djepin
Ditën që u bëra nënë,
S'e mbylla syrin për vete
I gdhiva netët pa hënë,
Dritë fëmijëve për t'u dhënë .
Nuk m'u deshën salltanete,
Se janë bota, gjithësia,
Drita e syve, perëndia.

UNË ERDHA NË KËTË JETË

Unë erdha në këtë jetë
Me dëshirë e me vullnet,
Nga një dashuri e bardhë,
Nga dy zemra qelibar.